

INFORMAZIONE
PER PRINDER

Kapsläku (Konstipacioni)





Kapsllëku (Konstipacioni)

Në moshën e fëmijërisë shpesh vjen deri te paraqitja e kapsllëkut. Po që se fëmijët janë të prekur nga kapsllëku, atëherë kërkohet shumë durim dhe terapi konsekuente, për të u kthyer deri te jashtëqitja normale.

Jashtëqitja normale

- foshnjat në gji:
10x/ditë deri 1x çdo të 10. ditë
- foshnjat e ushqyera me shishe:
rreth çdo 1 - 2 ditë
- fëmijët e vegjël, fëmijët, të rriturit:
rreth çdo 2 ditë

Kapsllëku (Konstipacioni)

- foshnja / fëmija ka gjithmonë dhimbje barku në lidhje me jashtëqitje
- jashtëqitje e vogël sferike dhe e fortë, zbrazje e zorrëve pjesërisht me jashtëqitje të hollë (në formë të shkuarjes së barkut, diaresë) e mundur para dhe pas kapsllëkut
- fëmijët, që më parë ishin të pastër, papritmas kanë prapë gjurmë të jashtëqitjes në ndërresa apo kanë jashtëqitje të pa vullnetshme.
- gjak në letër tualeti apo shtresa të holla të gjakut në jashtëqitje, janë të mundura nga qarjet e holla të mukozës në anus.

- rrallë herë vjellje

Shkaqet

Për shkak të faktorëve të ndryshëm (Ndërrimi i ushqimit, sëmundjet infektive, të ushqyerit e gabuar, udhëtimet, pamëshira e shkuarjes në tualet) jashtëqitja mund të ngurtësohet dhe fëmija fiton përvojën, që jashtëqitja shkakton dhimbje. Me këtë fillon, me vetëdija apo pa vetëdije, të përmbahet dhe nuk shkon në tualet. Në këtë mënyrë jashtëqitja ngurtësohet edhe më tepër dhe kështu do të i shkaktoj fëmijës sërisht dhimbje gjatë jashtëqitjes vijuese. Kështu krijohet një rreth i mbyllur. Nëse ky rreth nuk ndërpritet, fëmijës do i grumbullohet gjithnjë e më tepër jashtëqitje në zorrën e trashë. Kështu vjen deri te mbushja tej mase: në mënyrë paradoksale tani fëmijës papritmas i shkon barku, mund të humbë jashtëqitje pa vetëdije apo të ketë

njolla jashtëqitje në ndërresa. Më së voni tani ky problem do të duhej të sqarohet dhe të trajtohet me konsekuencë.

Faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në sjelljen e jashtëqitjes së fëmijës tuaj (si për shembull të ushqyerit e gabuar apo lëvizja e pakët). Mirëpo këta faktorë nuk janë kurrë të vetmit si shkaktarë të një kapsllëku.

Sëmundjet serioze si shkaktarë të kapsllëkut janë të rralla. Ndonjëherë munden disa medikamente të shkaktojnë jashtëqitje të çrregulluar (preparate hekuri). Ekzistojnë, në raste të rralla, fëmijë të cilët dalja e zorrës së trashë nuk është zhvilluar normalisht në aspektin nervor (Morbus Hirschsprung). Këta fëmijë që nga lindja lëngojnë nga kapsllëku.

Mjekimi

– Fyzat: ndonjëherë jashtëqitja e ngurtësuar duhet të nxjerrët me fyza nga fundi i zorrës së trashë. Porse kjo gjithmonë do të duhej të ndodhë me marrëveshje mjeku dhe nuk guxon të jetë masa e vetme e marrë kundër kapsllëkut.

- Laxantien (Mjete ndihmëse për jashtëqitje): shpesh rrethi i mbyllur i kapsllëkut duhet të ndërpritet me medikamente. Këto mjete ndihmëse e zbusin jashtëqitjen dhe mundësojnë një jashtëqitje pa dhimbje. Edhe nëse Laxantien merret rregullisht për një kohë të gjatë, nuk vjen deri te varësia nga ai.
- ushqim të shëndoshë, të matur dhe në përputhje me moshën
- «Trajnim tualeti»: pas çdo shujte përmes marrjes së ushqimit vjen deri te aktivizimi i zorrëve dhe eventualisht edhe deri te zbrazja e zorrëve (Refleksi gastro kolik). Për këtë arsye fëmija do të duhej 1 – 2 x në ditë pas shujtave të vendoset mbi tualet, me qëllim të shfrytëzimit të këtij refleksi. Është me rëndësi, që të kujdeseni për një pozitë të përshtatshme të uljes së fëmijës (stola për vendosjen e këmbëve, që fëmija juaj të mos «varet» në govatë të tualetit).
- Evitoni gjithsesi: mos stimuloni / manipuloni me termometër në dalje të zorrës së trashë, pasi që kjo mund të shkakton lëndime.

Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni me pagesë për këshillime: 0900 266 71 1



Kur do të duhej të e vizitoni mjekun?

- kur fëmija juaj ankohet mbi dhimbje barku të pandërprera dhe rritje të tyre
- kur fëmija juaj ka barkqitje masive (me/pa vjellje)
- kur fëmija juaj që nga lindja apo çë një kohë të gjatë lëngon nga kapsllëku
- kur fëmija juaj vazhdimisht ka gjak apo sekrete të përziera në jashtëqitje
- kur fëmija juaj nuk shton më në peshë
- kur ju merakoseni edhe për shkak të një arsye tjetër për fëmijën tuaj

© Ekipi i emergjencës, Spitali i fëmijëve Zürich Tetor 2009



UNIVERSITÄTS-
KINDERSPITAL
ZÜRICH

Das Spital der
Eleonorenstiftung

Kinderspital Zürich - Eleonorenstiftung
Steinwiesstrasse 75
8032 Zürich

www.kispi.uzh.ch